



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL**

Nr. 243/3 prot.

Tiranë, më 12.11.2018

**VENDIM**

**Nr.87, datë 12.11.2018**

**PËR**

**PËRFUNDIMIN E PROCESIT TË VERIFIKIMIT TË EKZEKUTIMIT TË  
VENDIMIT TË KOMISIONERIT NR. 42, DATË 10.05.2018**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, dhe Rregulloren, *“Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”*, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Çështjeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë, në lidhje me verifikimin e zbatimit të Vendimit Nr. 42, datë 10.05.2018, *“Për një shtesë në vendimin paralajmërues nr. 203, datë 9.10.2017, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, “Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil në njësinë e vetëqeverisjes vendore, Bashkia Lezhë dhe paralajmërimin e institucionit për të rregulluar gjendjen e paligjshmërisë”*”, në Bashkinë Lezhë.

**KONSTATOVA SE:**

Nëpërmjet kërkesës të regjistruar pranë Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil me nr. 21 prot., datë 15.01.2018, punonjësi \*\*\*\*\*\*, me detyrë *“Specialist Jurist”* në Drejtorinë e Financës dhe Buxhetit, pranë Bashkisë Lezhë ka kërkuar mendimin juridik të Komisionerit, nëse ai e gëzon statusin e nëpunësit civil në kushtet kur plotëson kriteret, pasi njësia e burimeve njerëzore nuk i ka dhënë aktin e deklarimit të statusit si *“nëpunës civil”*.

Pas hetimit administrativ të këtij rasti, Komisioneri ka përmbyllur procesin me Vendimin Nr. 42, datë 10.05.2018, *“Për një shtesë në vendimin paralajmërues nr. 203, datë 9.10.2017, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, “Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil në njësinë e*

vetëqeverisjes vendore, Bashkia Lezhë dhe paralajmërimin e institucionit për të rregulluar gjendjen e paligjshmërisë”, në të cilin është vendosur:

“1. Ndryshimin e pikës 7, të Vendimit paralajmërues nr. 203, datë 9.10.2017, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në lidhje me emërimet në kundërshtim me procedurën e përcaktuar në ligjin nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, në pjesën ku flitet për punonjësin \*\*\*\*\*, duke e shfuqizuar atë.

2. Shtimin në pikën 3, të Vendimit paralajmërues nr. 203, datë 9.10.2017, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, ku ngarkohet njësia përgjegjëse, që, për të gjitha rastet e konstatuara, të nxjerrë aktet e deklaramit të statusit të punësimit në kategorinë “nëpunës civilë”, duke e plotësuar këtë pikë si më poshtë:

- Njësia përgjegjëse e institucionit, në rastin e punonjësit \*\*\*\*\*, duke patur parasysh që: a) pozicioni i punës është pjesë e shërbimit civil; b) punonjësi ka më shumë se një vit, që e kryen detyrën funksionale në atë pozicion pune; si dhe c) plotëson kriterin e nivelit arsimor të diplomës së arsimit të lartë (punonjësi disponon diplomë të arsimit të lartë si “Jurist”), të nxjerrë aktin e deklaramit të statusit të punësimit në kategorinë “nëpunës civil”, në pozicionin “Specialist Jurist”, në Drejtorinë e Financës dhe Buxhetit, pranë Bashkisë Lezhë.

- Në kushtet kur punonjësi \*\*\*\*\* është nëpunës civil, pozicioni i punës “Specialist Jurist”, nuk konsiderohet vend i lirë dhe punonjësi në fjalë nuk i nënshtrohet procedurave të konkurrimit.

3. Njësisë përgjegjëse të institucionit, i tërhiqet vëmendje për mosveprimin në lidhje me deklaramin e statusit të punësimit për punonjësin \*\*\*\*\*, mosplotësimin e dosjes së personelit me të gjitha aktet që tregojnë zhvillimin e karrierës së nëpunësisë si në rastin konkret, si dhe mosvënien në dispozicion të Komisionerit të materialeve gjatë procesit të mbikëqyrjes.

4. Të njoftohen për këtë vendim, Bashkia Lezhë dhe njësia e burimeve njerëzore të institucionit, si dhe nëpunësi \*\*\*\*\*.

5. Për kryerjen e detyrave të përcaktuara më sipër, institucionit i lihet afat, **10 ditë.**”

Me kalimin e afatit procedural të lënë për zbatimin e rekomandimeve të Vendimit paralajmërues të Komisionerit Nr. 42, datë 10.05.2018, Bashkia Lezhë ka informuar Komisionerin për zbatimin e këtij vendimi.

Konkretisht, njësia përgjegjëse pranë Bashkisë Lezhë, në përputhje me pikën 2 të dispozitivit të vendimit objekt verifikimi, ka marrë masat e duhura dhe me aktin nr. 3947 prot., datë 21.05.2018, ka deklaruar si “nëpunës civil” punonjësin \*\*\*\*\* në pozicionin “Specialist Jurist”, pranë kësaj bashkie.

Për sa u parashtrua më sipër, rezulton se nga ana e institucionit, Bashkia Lezhë, janë zbatuar rekomandimet e lëna në vendimin paralajmërues Nr. 42, datë 10.05.2018, *“Për një shtesë në vendimin paralajmërues nr. 203, datë 9.10.2017, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, “Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil në njësinë e vetëqeverisjes vendore, Bashkia Lezhë dhe paralajmërimin e institucionit për të rregulluar gjendjen e paligjshmërisë”*”.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar; ligjin nr. 44/2015 *“Kodi i procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”* dhe Rregulloren, *“Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”*, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

### **VENDOSA:**

1. Përfundimin e procesit të verifikimit të zbatimit të Vendimit Nr. 42, datë 10.05.2018, *“Për një shtesë në vendimin paralajmërues nr. 203, datë 9.10.2017, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, “Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil në njësinë e vetëqeverisjes vendore, Bashkia Lezhë dhe paralajmërimin e institucionit për të rregulluar gjendjen e paligjshmërisë”*”.
2. Konstatimin e rregullimit të ligjshmërisë nga ana e subjektit të inspektuar Bashkia Lezhë, duke zbatuar plotësisht rekomandimet e Vendimit Nr. 42, datë 10.05.2018.
3. Për këtë vendim të njoftohet institucioni Bashkia Lezhë, dhe ankuesi \*\*\*\*\*.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

### **KOMISIONERI**

**Pranvera Strakosha**